Vdekje fashizmit — Liri Popullit

Poštarina plaćena u gotovu
Taksa postale e paguese

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

NEDELNI LIST
FLETORE E PERJAVESHME

Redaksija: Prishtine
Rruga Emin Duraku Nr. 1

PAJTIMET
per 1 vit 96 din
— 6 muej 48 —
— 3 muej 24 —

Dorshkrimet nuk kthehen

Odgovorni urednik XHELADIN
Drejtori pergjegjes HANA

Vjeti IV Nr. 118 | PRISHTINE, 19 Qershuer 1948 | Çmimi 2 dinarë

Ne ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis te korrim fitore te reja e te randsishme ne ndertimin socjalist t'adheut t'one

Vendimi i Plenumit te Komitetit Qendror te Partis Komuniste te Jugosllavis per thirrjen e Kongresit te Peste te Partis asht pritë me entuzjazem te madh ne mbare atdheun t'one, pra edhe ne Krahinen t'one, nga shtresat e gjana punuese, e ne rradhe te pare nga klasa puntore. Puntorija, katundarija punuese, mbare populli i jone puntuer asht ngritë ne garen socjaliste per ndere te kongresit te Peste te PKJ, tue ndermarre detyrimë te reja pune. Ne Krahinen t'one puntoret minatore te Trepçes ftuen per gare te gjithe kolektivet punuesa te minjerave dhe fonderive te metaleve te ngjyrshem te Vendit dhe premtuen se 21 korikun, ditën e hapjes se kongresit, do t'a presin me fitoret ma te mdhaja ne pune. Si kudo, an'e kande te atdheut t'one te ri, shtresat e gjana popullore te Krahines s'one pregatiten per t'a pritë kongresin e Partis me rezultate te randesishme ne ndertimin socjalist.

Te gjitha keto na tregojne se Kongresi i Peste i Partis Komuniste te Jugosllavis nuk ka randesi vetem per antaret e Partis, por shenon nji ngjarje te randesishme edhe per te gjithe popujt t'one, per zhvillimin e matutjeshem te pushtetit populluer, per zgjidhjen e matutjeshme te problemeve ekonomike, politike dhe kulturale. Vala e garave socjaliste ne ndere te Kongresit te Partis provon edhe nji here lidhjen e fortë ne mes te Partis e popullit t'one puntuer, si edhe dashtunin qe ushqejne per Partin shtresat e gjana punuese, çka buron nga fakti se Partija Komuniste ka rrolin udheheqes ne Vendin t'one, mban para popujve t'one pergjegjesi per zhvillimin e matutjeshem dhe ardhmenin e atdheut t'one.

Kongresi do t'a permbledhe eksperijencen e pasun te Partis dhe ne baze t'asaj ka me i shtrue detyret e ardheshme dhe me caktue rrugët neper te cilat duhet te drejtohen te gjitha perpjekjet e popujve t'one.

Kongresi ka me i shtrue detyret konkrete ne luften e matutjeshme per Planin pesvjeçar dhe ndertimin e socjalizmit. Nepermjet te tij populli puntor i Vendit t'one ka me e kuptue edhe ma mire se lufta per socjalizem nuk asht nji punë e lehte, se ajo kerkon mobilizimin e te gjitha mjeteve dhe njerezve punuesa, se suksesi i kesaj lufte mvaret nga udheheqja e organizueme dhe me plan e mbare veprimtaris se popujve t'one. Kongresi ka me tregue se çfare mundesinash kolosale u jane sigurue popujve t'one me permbysjen e rendit shoqnuer kapitalist dhe, nepermjet te Partis, me i mesue masat t'ona punonjese se si me i perdore keto mundesina ne ndertimin socjalist dhe per shpejtesimin e procesit te ketij ndertimi. Ai, mandej do t'ia boje kryekput te kjarte popullit t'one puntuer se per Vendin t'one, si Vend i demokracis se vertete popullore, dhe per perparimin e tij te matutjeshem nen kushtet e kohes s'one nuk ka rruge tjeter perveç rruges se ndertimit te socjalizmit.

Nji nga detyrat ma te veshtira, mbas marrjes se pushtetit qe ka me ju dashte Partis dhe, nen udheheqjen e saje, Frontit t'one popullor me e zgjidhe, asht patjeter çashtja e katundit, duem te themi çashtja e cuemjes se katundaris se vogel e te mesme ne rrugen e socjalizmit. Kongresi i Peste ka me e analizue si duhet edhe ket çashtje e me dhane gjykimin mbi te gjitha masat organizative dhe ekonomike te ndermarruna deri tashti ne luften kundra elementave kapitalista ne katund. Kongresi ka me tregue se Partija ashtu siç ka qene e zoja me e drejtue luften revolucjonare nen kushtet ma te veshtira, asht e zoja me e drejtue edhe betejen-qe po zhvillohet dhe do te ndezet edhe ma teper-per ndertimin e socjalizmit, e cila, siç na ka tregue eksperienca e deritashme, kerkon po aq shpirt sakrifice, vetmohim e heroizem sa edhe revolucjoni me arme. Suksesei e korruna deri tashti, suksesi ne zhdukjen e te metave, koshjenca per veshtiresin e detyreve dhe zhvillimi i matutjeshem i fuqive krijuese te popujve t'one jane parakushtet qe na sigurojne se populli puntuar i Vendit t'one, i bashkuem ne rradhet e Frontit Popullor, e nen drejtimin e Partis Komuniste ka me dale triumfues edhe ne luften per ndertimin socjalist.

Kongresi i Peste ka randesi te madhe per forcimin e matutjeshem te Partis Komuniste te Jugosllavis. E forcimi i Partis don te thote forcim i Frontit t'one Popullor, qe udhehiqet prej saje, don te thote forcim i mbare popullit t'one puntor, qe lufton, nen drejtimin e saje, per ndertimin e socjalizmit. materjalet e Kongresit te Partis kane me qene nji visar i çmueshem per naltesimin ideologjik jo vetem t'antarve te Partis, por edhe atyne t'organizatave te tjera popullore, qe drejtohen nga Partija, e ne rradhe te pare antareve te Frontit t'one popullor.

Nepermjet te materjaleve te kongresit, Partija e Fronti popullor nen drejtimin e saje kane me zhvillue edhe ma me sukses luften ideologjike, luften kundra botkuptimeve te vjetra te shoqnis kapitaliste. Kongresi do te tregoje se si pa luften kundra atyne botkuptimeve e pa edukimin e massave te popullit ne frymen e re, socjaliste, s'mund te zgjidhen me sukses as problemet e tjera; Kongresi ka me tregue se si duhet t'ashpersohet dhe zgjanohet lufta ideologjike ne te gjitha fushat e ndertimit ekonomik dhe kultural.

Kongresi i Peste i Partis po mbahet ne nji kohe kur kampi demokratik anti imperjalist botnuer, me Bashkimin Sovjetik ne krye, po zhvillon nji lufte te rrepte kundra fuqive t'imperjalizmit, ne krye te te cilave ndodhen barkmbdhajt e kapitalit financjar amerikan, qe ndjekin politiken nxitese te luftes Kongresi do te konfirmoje perseri se Vendi i jone qendron i patundshem si pjese perbase e fuqive paqedashese te botes dhe te interesat e tija, nder te gjitha çashtjet nderkombtare, jane identike me interesat e Bashkimit Sovjetik dhe te vendeve te demokracis popullore. Kongresi ka me qene edhe nji manifestim i fuqishem i dashunis se Partis s'one dhe, nepermjet te saje, popujve t'one ndaj Bashkimit te madh Sovjetik, udheheqesit dhe mesuesit te botes perparimtare-Stalinit. Popujt t'one e popujt e shteteve te tjera te demokracis popullore jane te vetedijshem se ata muejne me i nderte punes te tyne paqesore, ne rradhe te pare, ne saje te rrolit qe lot sot Bashkimi Sovjetik ne bote.

Qe sepse njerzit punuesa t'atdheut t'one, pra edhe te Krahines s'one e cila, ne saje te Partis Komuniste asht ba djep bashkimi e vllaznimi dhe bere me hapa te shpejte perpara ne luften kundra mbrapambetjes ekonomiko-kulturale te trashigueme nga regjimi i vjeter kapitalist, dhe per zhvillimin e saje te gjithanshem-kane vendose me e pritë kongresin e Peste te Partis se vet me fitore te randesishme ne ndertimin socjalist.

Popujt e Kosoves e Metohis, shqiptar, serb e malazez, tue zhvillue garat socjaliste ne çdo sipermarrje, ne çdo kooperative, nder minjera, nder institute; nder qytete e katunde, ne çdo shkolle e klase, kudo qe punohet per zhvillimin e Krahines e atdheut t'one pergjithesisht, ne Beogradin e ri, n'autostraden "Vllaznimi e Bashkimi", ne hekurudhen Kuçevo—Brodice, tue n-pergjegje ne mase per huan popullore, per kontraktimin e drithnaveve tue me çfaqe fuqishem dashtunin e vet ndaj pararojes se popujve t'one ne luften çlirimtare me arme e ne betejen per ndertimin socjalist, Partis Komuniste dhe drejtuesit te saje Titos.

Le te mos mbese asnji kolektiv pune, asnji njeri i ndershem, i madh a i vogel, pa marre pjese ne garen e pergjithshme popullore, socjaliste, ne ndere te kongresit te Peste te Partis. Me dhane per Partin, d.m.th. me dhane per jeten t'one te lumtun. Me nderue Partin d.m.th. me nderue popujt t'one, me nderue atdheun t'one te ri, me nderue vetvehten t'one.

Huaja e mbrendshme popullore shpejteson ndertimin socjalist te Vendit t'one

Qeverija qendrore e RFPJ shpalli huan e Planit pesvjeçar te zhvillimit ekonomik te Vendit t'one. Populli punonjes te Vendit t'one atdheu i vet socjalist i kerkon huan prej 3 miljarde e 500 miljona dinare, per shpejtesimin e ndertimit socjalist ne kuadrin e Planit pesvjeçar te zhvillimit ekonomik.

Gjithkush e din se ke na pushteti dhe pozitat komanduese t'ekonomis gjinden ne duer te popullit puntuer. Fakti asht edhe se plani i pergjithshem shtetnuer per vjetin e pare te Petolektkes asht realizue plotesisht e prodhimi industrijal, i shtuem me 64% ne krahasim me vjetin e kaluem, ne tremuejshin e pare te vjetit te dyte asht plotesue qind per qind. Edhe deget e tjera t'ekonomis s'one, te zgjanueme gjithashtu ne krahasim me vjetin e kaluem, i kane plotesue planet tremuejshe te vitit te dyte. Bujqesija e jone, ne zhvillimin e saje ne kuadrin e Planit, po hece me hapa te mdhaj perpara. Populli i yne e shef dhe e ndjen ket perparim. Qe disa fakte:-standardi jetesuer i masave punonjese po permiresohet dita dites, deri ne fund te ketij vjetit do t'a arrije indeksin 107 ne krahasim me indeksin 100 ne vjetin 1939 dhe me indeksin 86,87% te vjetit 1947. Vlera e konsumimit, e shprehun me çmimet e vjetit 1939, do te jete sivjet se paku 49.576.977.000 dinare, ndersa ne vjetin 1939 ka qene 46.329.246.000 e ne vjetin 1947—40.605.429.000 dinare. Dekret—ligji mbi çmimet e lidhuna, al mbi kontraktimin e drithnave ia ka sigurue katundarit t'one mundesin me u-pajise me te gjitha gjanat e nevojshme ne menyren ma te lehte. Veç kesaj katundarit t'one ket vjet i asht paksue tatimi mbi t'ardhunat 40% ne krahasim me vjetin e kaluem.

Pra shtimi i prodhimit ne te gjitha deget e ekonomis, shtimi i t'ardhunave popullore, ngritja e standardit jetesuer te masave, permiresimi gjithnji ma i madh i gjendjes ekonomike-perparimi i gjithaneshem i shtetit, ky asht faktori qe e ka ba te mundeshem dhe e ka kerkue ket hua te mbrendshme. Kushtet e huas per te cilat do te flasim ma poshte, mundet me i dhane vetem shteti i popullit punonjes ku "interesat e çdo njeriut punonjes si individ perputhen me interesat e shtetit, dhe interesat e shtetit me interesat e çdo njeriut punonjes"-(Dobrivoje Radosavljeviq). Ne shtetet kapitaliste huanat shpallen ne kohen e depresjonit ekonomik, ne kohen e krizave te ndryshme ekonomike-karakteristike per kapitalizmin-dhe me qellim qe t'i rjepin shtresat e gjana popullore per t'a mbulue deficitin shtetnuer. Te hollat qe i merr shteti kapitalist si hua nuk perdoren per qellime produktive. Ato e shtypin popullin puntor. Ne Jugosllavin e vjeter kapitaliste shteti shpallte huana te mbredeshme e te jashtme. Huanat e mbrendeshme i jepshin kapitalistat, pronaret e mdhaj dhe bankjeret, prandaj edhe ishin ne dobi te tyne. Te gjitha kamatat qe ua jepte huadhansve shtepi bijshin ne kurriz te popullit,-shteti ia shtonte popullit tatimet dhe taksat mbi prodhimet e tija, e çfrytzonte me maksimum. Mandej, keto huana ishin edhe mjet spekulimi: tregetaret hapshin parulla se si shteti nuk do t'a kthejë huan; keshtu i humlishin njerezit injoranta dhe na blejshin leter-obligimet, me te cilat spekullojshin dhe nxjershin fitime te mdhaja. Huanat e jashtme ishin edhe ma te randa per popullin dhe per mbare vendin. Shteti kapitalist-huadhanes-i jepte paret nen kushte shume te randa,-kerkonte koncesjone dhe kamata aq te mdhaja sa shteti jo vetem ia shtonte popullit tatimet e taksat e padurueshme, por detyrohej me ia leshue shtetit huadhanes kapitalist bozat e landeve te para per t'i çfrytezue deri sa te likuidohet borxhi me kamaten e tij. Ne ket menyre, Jugosllavija e vjeter e ka qite popullin ne mjerim, vendin ia ka nenshtrue ekonomikisht kapitalizmit te huej imperjalist dhe yetvetin ka ra nen influencen e tij politike deri sa me ne fund u-ba viktime e fashizmit italo-gjerman. Dhe kjo asht gja e zakonshme. P.sh. Turqija, Italija, Franca, Anglija, Spanja fashiste etj., tue marre hua prej Volstritve, jane ba vasale dhe sherbetore direkte t'imperjalizmit amerikan, i cili ma ne fund do t'i kthente keto vende ne koloni te veta.

Na nuk duem huana nga jashta sepse nuk na interesojne. Shteti i yne kerkon hua prej popullit dhe per popullin. Kjo hua nuk asht mjet qe mbulon deficite, ase mjet me te cilin spekulojne kapitalistat tregetare. Kemi huaja te cilen e kerkon atdheu asht pasoje e perparimit ne ndertimin e ekonomis socjaliste dhe ka per qellim shpejtesimin e procesit te ketij ndertimit, qe asht n'interesin e popullit puntor. Ne shtetin t'one socjalist, sa ma e forte te jete baza financjare e planit t'one, aq ma shpejt dhe ma teper permiresohen kushtet e jeteses se popujve t'one.

Shuma e 3 miljarde e 500 miljona dinarve, te cilen atdheu e kerkon prej njerezve punonjes si hua, gjate ndertimit me plan do te kthehet ne fabrika te reja, ne centrale te reja elektriku, ne minjera, rruge e hekurudha te reja, ne shkolla, shtepija kulture e institute tjera te reja popullore.

(Vazhdon ne faqen 2)

GARAT PER NDERE TE KONGRESIT TE PESTE TE P.K.J.

Kudo ne Krahinen t'one zhvillohen gara ne ndere te Kongresit te Partis

Komitetit Qendruer te Partis Komuniste te Jugosllavis

Ne konfefencen e sotshme te perfaqesuesavet te drejtorive te vend-ndertimeve te shtepijave kooperative te Bashkimit koperativ te rrethit dhe te kooperativave te vendeve, te gjithe pjesemarrsit ne konference vendosem:

1) Qe per ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis, deri me 21 korrik 1948, ma para se te gjitha drejterinat e punimeve te shtepijave kooperative ne Kosmet, kemi me i ndertue plotesisht tri shtepija kooperative si ma poshte: ne keshillin populluer te vendit Brekoc-shtepin kooperative te tipit te dyte, ne keshillin populluer te vendit Batushe te tipit te trete, dhe ne keshillin populluer te vendit Junik-te tipit te katert.

2) U shpallim gara per ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis te gjitha rretheve te Krahines se ne vjetin e dyte te Planit Pesvjeçar kemi me i ndertue te paret shtepijat kooperative dhe me i aftesue ato per pune.

Pjesemarrsat e konferences bijne ket vendim, tue qene koshjenta n'udhehegesin e sigurte e te provueme te Partis s'one me shokun Tito ne krye, ne shej mirenjohjeje ndaj Partis s'one dhe shokut Tito qe ka krijue kushtet per ngritjen ekonomike e kulturo-arsimore te massave shqiptare, serbe e malazeze ne Kosmet, per vllaznimin e bashkimin e forte te farkuem ne mes te popujve te Kosoves e Metohis. Ne kushte te ketilla na jemi te sigurte se keto detyra do t'i kryejme dhe planin t'one do t'a tejkalojme.

DREJTORIJA E NDERTIMEVE TE SHTEPIJAVE KOOPERATIVE TE RRETHIT TE GJAKOVES

Kolektivi i „Gračanices" do t'a kaprceje planin e prodhimit me 30%

Njerzit e mundit te Krahines s'one po e manifestojne per dite e ma teper dashunin e tyne te madhe ndaj Partis Komuniste te Jugosllavis, tue marre zotime ne garat per nderin e Kongresit te peste. Kolektivi puntuer i sipermarrjes "Graçanica" mbajti me 11 te ketij mueji nji konference solemne ku u-mblodhen rezultatet e dekades se pare te planit te garave per muejin qershuer dhe u-shperndane tre flamujt kalimtare te deges sindikale. Flamujt i fituen tri brigadat ma te mira.

Brigada me e mire e mallteristave ne dekaden e pare e ka krye planin e prodhimit per 82,71% dhe e ka tejkalue normen per 143%.

Brigada e murratorve e ka krye planin e prodhimit 75,05%, dhe brigada ma e mire e puntorve te pakualifikuem e ka tejkalue planin 60,50%.

Ne ket konference kolektivi puntuer i sipermarrjes "Graçanica" muer detyrimet e reja ne gara per ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis. Kolektivi asht zotue se planin e prodhimit te sipermarrjes do t'a kaperceje deri ne diten e Kongresit per 30%, do t'a kurseje ne pune materjalin e ndryshem 7% dhe do t'a çfrytezoje racjonalisht fuqin puntore. Mandej kolektivi asht zotue se deri ne diten e Kongresit do t'i kryeje te gjitha zotimet qe i ka marre ne lidhje me ndertimin e shtepijave kooperative, asht zotue se do t'a mbaroje ndertimin e shtepis se Kultures ne Prishtine, do t'i kryeje 10 ndertesa baneje ne Prishtine-ne blokun e ri te banesave, ambulanten dhe ndertesat e baneses se nepunsave te Filijales se sigurimit social, do t'a kryeje ndertimin e Shkolles se mesme bujqesore ne Prishtine, ndertesen e puntoris se stacjonit maqino-traktorist, shtallen e stacjonit bujqesuer modelor ne pasunin bujqesore te shtetit dhe dy magazinat e drithit ne Podujeve. Ky kolektiv i fton ne gara te gjithe kolektivat e sipermarrjeve te ketij llojit ne Kosmet mbi zotimet e marruna dhe mbi planin qe ka dergue Ministrija e Botores ne qeverin e RPS.

Nga kjo konference i asht dergue telegram pershendetes Komitetit Qendruer te Partis Komuniste te Jugosllavis, me te cilin zotohen se do t'i kryejne te gjitha zotimet e marruna deri ne diten e Kongresit.

Ne telegram pershendesin njikohesisht vendimin e Komitetit Qendruer mbi thirrjen e Kongresit, tue ia njoftë meriten Partis Komuniste te Jugosllavis per perpjekjet e saja vigane ne luften kundra okupatorit fashist dhe ne luften per ngritjen e socjalizmit ne vendin t'one.

KOOPERATIVA „NJI MAJ" SHPALLE GARA

Kooperativistat e kooperatives bujqesore "Nji Maj" ne Devet Jugoviq mbajten nji mbledhje te jashtzakonshme, ne te cilen vendosen me u shpalle gara te gjitha kooperativave bujqesore te Kosmetit per ndere te Kongresit te V-te te Partis Komuniste te Jugosllavis.

Ne letren qe u kane dergue te gjitha kooperativave, bujqit kooperativista te Devet Jugoviqve ftojne ato ne gara mbi keto pika:

kush do t'a organizoje ma se miri punen dhe t'a zbatojne disiplinen ma te mire ne pune, cila kooperative do t'a zbatoje ma mire sistemin e punes ne brigada dhe grupe, cila kooperative do t'i kryeje ma me suksese planet dhetedithshe operative dhe sezone; cila kooperative do te ndertoje e para objektet e nevojshme ndertimore. Ne fund, kooperativistat iu luten te gjitha kooperativave t'a pranojne garen dhe t'i njoftojne mbi te, me ane te shtypit krahinuer.

MINJERA GOLESH DO T'A KALOJE PLANIN 100%

Kolektivi puntuer i minjeres "Golesh" te magnezitit, per ndere te Kongresit te V-te Partis Komuniste te Jugosllavis, asht zotue nder te tjera se gjate garave te para-kongresit do t'i zbres shpenzimet e parapame me plan per 6%, se do t'a hartoje projektin dhe do te ia filloje punimeve te reja, te cilat do t'a bojne te mundun kapercimin e planit te sotshem te prodhimit 100%.

PRISHTINE:

Ne Keshillin sindikal te rrethit te Prishtines u-mbajte konferenca me te gjitha komisjonet e garave dhe te punes kulturo-arsimore ne teritorin e ketij rrethi. Konferenca u-mbajte ne lidhje me organizimin e garave per ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis dhe per organizimin e dhanjes se huas nga ana e massave punonjese-shtetit t'one.

Ne Konference u-analizue randesija e madhe qe ka Kongresi i Peste i Partis, huaja e mbrendeshme shtetnore, Dekret-ligji mbi kontraktimin e drithnave. Ketu u-dhane te gjitha udhezimet e nevojshme per hartimin e planeve te garave dhe per zbatimin e potimeve te dhanuna nga puntoret dhe nepunsat. U-theksue sidomos qe te me rren zotime me qellim te kryemjes se detyrimeve qe i ka marre Kshilli i Frontit popullor te qytetit te Prishtines, si pergjegje ne ftesen e Novi Sadit per garat per ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis.

Ne ket mbledhje u-vendos qe te gjitha organizatat sindikale te marrin pjese ne dhanjen e huas shtetit t'one.

Fronti i qytetit Prishtine i pergjigjet fteses se Novi Sadit ne gara

Keshilli ekzekutiv i Frontit populluer per qytetin e Prishtines mbajti nji mbledhje ne te cilen vendosi me e pranue garen ne te cilen i fton Fronti populluer i Novi Sadit te gjitha qytetet e Republikes Popullore te Serbis. Tue e pranue garen, Fronti i qytetit te Prishtines asht zotue se neper te gjitha keshillat e frontit neper bloqe e rruge do t'i formoje drejtorinat e ndertimit, do te pastrohen te gjitha terenet ku asht ne projekt te ndertohen objektet e reja, do t'i kryeje te gjitha punet toksore ne rrugen Prishtine-Germi, prej 20-27 qershuer do te zbatohet java e partis, do te formohen ne te gjitha lagjet çetat dhe grupet puntore te puntorve dhe nepunsave t'enteve shtetnore, te cilat do te punojne neper objekte te ndryshme. Fronti antifashist i grave te Prishtines asht zotue se do t'i ndertoje do fusha loje per femijt t'one. Do te ndihmohet vetiniciativa e blokut XI,XII e XIV per ndertimin e shtepijave te Frontit.

Vet Kshilli i Frontit u-zotue se do te marre çdo mase dhe do t'angazhohet me te gjitha forcat qe ka per pjesemarrjen sa ma aktive te brigadave dhe çetave puntore ne pune per kryemjen e zotimeve dhe planit te parapame te Frontit.

Organizata e grues se qytetit te Prishtines shpalle gara

Keto dite antifashistet e qytetit te Prishtines mbajten konferencat solemne n'organizatat themelore ne te cilat kane marre zotime te reja per ndere te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis. Jane zotue se do te çelin edhe dy kurse te reja kundra analfabetizmit dhe 10 grupe leximi per grate shqiptare. Asht vendose qe ne te gjitha organizatat themelore te mbahen ligjerata mbi randesin e Kongresit te Peste te PKJ dhe mbi randesin e javes se femijve. Mandej jane zotue se do t'i ndertojne deri ne diten e Kongresit te Partis dy fushat e lojes dhe sportit per femijt. Grate e Prishtines se shpejti para Kongresit, do t'a hapin bibliotekan prane Kshillit te FAO-es se qytetit te Prishtines. Veç kesaj, grate e qytetit te Prishtines do te japin 5,500 ore pune vullnetare deri ne diten e Kongresit per ndertimin e objekteve te ndryshme ne qytet. Ne lidhje me zotimet e marruna, grate e qytetit te Prishtines i ftojne ne gara te gjitha qytetet tjera te Kosmetit.

Organizata e Frontit duhet te ndimoje ma teper ne zhdukjen e te metave ne lidhje me kontraktimin e drithnavet

Ne Kosove e Metohi ka marre hov te madh lidhja e kontrateve per te pritmit e drithnave. Deri me 10 te ketij mueji, ne saje t'angazhimit te pushtetit populluer, organizatave masovike dhe Zhitopromet-it, i cili i ka organizue te gjitha masat teknike dhe ka dergue ne teren 112 nepunsa, dhe 16 revizore, qe t'organizojne dhe i ndihmojne kooperativat katundare, populli i Kosmetit ka kontraktue afer 320.000 kgr. drithna te bardha e miser. Rezultatet ma te mira i ka korre rrethi i Prishtines i cili ka kontraktue 150.000 kgr. drithna. Ne ket rreth dallohen sidomos keshillat e vendeve Obiliq e Milosheve. P.sh. ne Bresnje te Fushe-Kosoves disa bujqe si Mihailo Deniq, Vojisllav Veliçkoviq, Dragoljub Gjorgjeviq etj. kane kontraktue nga 6500 kgr. Asht karakteristike se keshilli i vendit Graçanice, me gjithe se rrethi i Prishtines asht i pari, deri me 8 te ketij muejit nuk ka mbajte as konferencen per spjegimin e Dekret-ligjit, e ma per lidhje te kontratave as nuk asht fole. Mandej vjen rrethi i Lipjanit ku jane kontraktue 100.000 kgr. Rezultate deri diku te mira jane mbrrijte edhe ne Peje e Gilan. Te dyja keto rrethe kane pranue garen e rrethit te Prishtines per ndere te Kongresit te Peste te PKJ, mbi lidhjen e kontratave. Rrethi i Pejes asht zotue se deri me 25 qershuer do t'a plotesoje planin e kontraktimit 100%. Simbas lajmit te korespondentit te gazetes "Rilindja", kontraktimi i drithnave ne rrethin e Drenices ka marre hov te madh. Mbrenda tri ditve jane kontraktue 367.515 kgr. drith.

Rezultatet do t'ishin shum ma madhaja sikur te kishte pase bona ne mjaftuni. E meta tjeter asht se bashkimet kooperative nuk kane porosite mallna te mjaftueshem. Ne gadi te gjitha rrethet mungojne mallnat jo vetem per bonat e tashem por edhe per bonat e leshueme perpara. Mandej shum kshilla te vendeve (Zhegra, Cernina, Vllashtica, Malisheva e Stanishori ne rrethin e Gillanit, pese kshilla ne rrethin e Rahovecit etj.) nuk ua kane dergue kooperativave regjistrat e prodhuesave simbas kategorive deri me 8 te ketij mueji, me gjithse afati ka qene deri me 3 qershuer. As kooperativat katundare nuk i dergojne referatet rregullisht (p.sh. 6 kooperativa ne rrethin e Rahovecit). Keto leshime rrjedhin nga pakujdesija e pushtetit lokal dhe bashkimeve kooperative, te cilat duket se nuk i kane dhane randesin e duhun Dekret-ligjit te ri. Asht koha t'u epet fund ketyne te metave dhe leshimeve sepse afati i lidhjes se kontratave kalon shpejt dhe katundari i yne, per shkak te pakujdesis dhe plogshtis se disave mundet me mbete pa i çfrytzue dobinat qe i ka sigurue shteti i jone me ane te ketij Dekret-ligji.

Shembulli i mire i Frontit Populluer te Istokut

Tash se fundi, Fronti populluer i rrethit t'Istokut organizoi edhe nji akcjon per punimet rreth centralit elektrik, qe po ndertohet ne ket vend.

N'akcjon mueren pjese afer 1.500 vete, nder te cilet te rit e te rejat, burra dhe gra, prej te gjitha keshillave te vendeve ma t'aferme. Katundaret t'one e kane marre ndertimin e centralit si pune ma serjoze. Po e shofin fort mire se sa pune e madhe bahet kur punojne se bashkut per te miren e vendit, shqiptaret bashke me serbet dhe malazezet. Ket here ne ket akcjon paraqitej nevoja e transportimit te gureve, te cilet ishin pregatite me kohe.

Ishte mjaft karakteristike kur dalloheshin ne pune perveç te rijve e te rejave edhe burra e gra te shtyem bukur nga mosha, te cilet nuk i lejshin gja mangut punes ne krahasim me ata te tjeret. Shquhej ne pune grueja 70 vjeçare Stana Patriq, e cila i shkrinte te gjitha fuqit e saja.

Nder te gjithe ata qe u-tregon ma aktive ne pune, qene e reja Spasenija Nikçeviq si dhe Millan Vukoviq, Stevka Nikiq, Ali Ramadani, Joro Tripkoviq dhe Sadri Dema.

Shembull te mire dhane edhe udheheqsat e organizatave masovike, te cilet mueren pjese edhe vet ne pune; nder keta ishin sekretari i keshillit te Frontit populluer te rrethit dhe antaret e keshillit te Frontit t'Istokut. Ne ket akcjon muren pjese edhe mesuesat e paragjimnazit dhe nji tjeter i shkolles fillore. Ne ket akcjon u-bajten afer 70 meter kubik gure.

Gjate punes, sipermarrja e filmave "Avalla" mori disa poza fotografije, te cilat kane me sherbye per filmin dokumentar te punimeve t'Istokut.

A. GASHI

(Vazhdon nga faqja e pare)

Huaja jepet keshtu: njerzit e punes te paku nga 500 dinare e ata qe nuk kane t'ardhuna, si p.sh. rinija, pionieret etj. nga 250 dinare e kthehet ne fund te vjetit 1952. Por, vjet per vjet, çdo huadhanes merr 10% kamate. D.m.th. fiton 10% ne huan e tij. Kamata paguhet ne te holla 6% e pjesa tjeter dmth. 4% hyn ne fondin e lotaris. Njeriu i yne punonjes jo vetem ndihmon shtetin e tij materjalisht, per t'a shpejtesue ndertimin socjalist, jo vetem shton forcen e vendit t'one per çdukjen definitive te mbeturinave kapitaliste ne Vendin t'one, por edhe i sjelle vehtes firime materjale, ia çon vleren dinarit t'one. Por ky fitim asht relativisht nji imtesi ne krahasim me randesin moralo—politike e ekonomike qe ka per popujt t'one kjo hua. Ne ket akcjon do te marrin pjese me miljona njerez punuesa te Vendit t'one. Ata do t'a tregojne edhe ma ket rase me vepra vendosmenin e tyne ne luften per Petoletken, per socjalizmin-jeten ma te lumtun.

Kongresin e Peste te Partis s'one te lavdishme Komuniste te Jugosllavis, njerzit t'one do t'a presin me fitore te mdhaja edhe ne ket drejtim. Edhe popujt t'one te Kosmetit po shofin me syt e tyne se si ne mbare Krahinen t'one po lejne fabrika e centrale te reja, po ndertohen shkolla te reja qe deri dje kane qene te hueja per te, ata po e shofin me syt e tyne traktorin tue e levrue token e tyne, po i shofin maqinat tue lehtesue punen e tyne. E te gjitha keto sigurohen prej investicjoneve te shtetit, te cilat rriten per çdo vjet ma teper simbas shtimit te prodhimit dhe t'ardhunave popullore.

Nepermjet te huas populli i jone puntuer do t'a shprehe dashunin qe ushqen ndaj asaj dhe shokut Tito. Huaja duhet te perfshije gjithkend. Puna rreth organizimit te huas nuk duhet te mbetet vetem ne disa konferenca. Çdo patriot i vertete do t'angazhohet me te gjitha forcat qe ka per te dhane hua.

Tue zhvillue gara per ndere te Kongresit te V-te te P.K.J. edhe huaja le te jete si pike e pare zotimi, sepse ndihma qe jep çdo individ forcon dhe shpejteson ndertimin e socjalizmit.

Kjo sakrifice per interesin e vet dhe te mbare kolektivitetit, asht shum e vogel ne krahasim me sakrificat qe kane dhane popujt t'one ne lufte kundra fashizmit. Popujt t'one kane heke kafshoren e bukes prej goje per t'a ndihmue luftetarin, kane hjeke teshat nga trupi per ta veshe luftetarin, kane fiijoe te kane pasunin per te fitue mbi fashizmin, kane vue jeten ne rrezik per jeten e lire e te barabarte, per bashkimin dhe vllaznimin e popujve t'one. Prandaj, edhe tash popujt e Kosmetit nuk do te kursehen, per do t'i dalin ne ndihme vetvehtes tue e dhane huan per Planin t'one pesvjeçar.

Nga Krahina

Tue i ndertue ma shpejte shtepijat kooperative, permirsojme ma shpejte jeten e katundeve

Nji nder detyret ma kryesore qe Kongresi i Dyte i Frontit Populluer te Serbis u ka shtrue te gjitha organizatave te Frontit Popullur, asht qe ata t'angazhohen n'afiesimin dhe perparimin e kooperativizmit. Per t'a shpejtue ket perparim, asht e nevojshme qe ne rend te pare te shtohet edhe ma fort hovi i punes ne ndertimin e shtepijave kooperative.

Ne Krahinen t'one kesaj detyre i jane perveshe ma me serjozitet organizatat e Frontit Popullor te rretheve ne Gjakove, Rahovec, Prishtine, Gillan dhe Ferizaj. Ne Gjakove nder te gjitha shtepijat kooperative, qe jane parapa ne plan, jane krye me kohe themelet, e ne disa ka fillue edhe muratimi i tyne. Po keshtu me rradhe vijne edhe rrethet tjera: Rahoveci, Prishtina, Gillani dhe Ferizaj. Nder keto rrethe Fronti Popullor e ka organizue punen ma mire, keshtu qe masat katundare kane dhane e po japin me mija e mija ore pune vullnetare, kane pregatite e transportue materjalin e nevojshem per ndertim, kane ndihmue materjalisht si me pare ashtu edhe me bageti, troje etj.

Ma se dobti qendron puna ne rrethin e Pejes, Vuçiternes, Kamenices e Dragashit.

Me rastin e mbajtjes te Kongresit te Peste te Partis Komuniste te Jugosllavis kane fillue te shpallen gara ne mes t'organizatave te Frontit Popullor te rretheve, se cili rreth ka me ndertue ma shum shtepija kooperative simbas tipit te parapame ne plan. Rrethi i Gjakoves i fton ne gare te gjitha rrethet e Krahines s'one, tue premtue se deri me 21 korrik-diten e mbajtjes se Kongresit te Partis Komuniste te Jugosllavis do te kryeje se ndertuemi 3 shtepija kooperative.

Mbajtja e Kongresit te Peste te PKJ duhet t'i najse massat t'ona punonjese puntore e katundare qe te shtojne sa ma fort hovin ne pune nder shtepijat kooperative dhe, njikohesisht t'i ndihmoje jo vetem individi individit, por edhe keshillat njeni tjetrit, e sidomos, ne sigurim dhe transport materjali, si lande, gelqere, gure etj. kur ato i mungojne ndonjenit prej tyne.

Frotistat e Junikut ndertojne me hov shkollen dhe shtepin kooperative

Frontistat e keshillit popullor te vendit Junik, te rrethit te Gjakoves, po ndertojne nji prej shkollave ma te bukura dhe ma te madha ne Krahinen t'one. Ndertesa po ngrihet ne katundin Junik. Punet shkojne mjaft perpara. Muret tash ma jane te gatshme.

Frontistat e ketij keshilli, n'anen tjeter, jane tue punue me te gjitha fuqit e tyne per ngritjen e shtepis kooperative. Ata kane çele dhe pregatite 13 furra gelqere, ne te cilat jane pjeke 195.000 kgr. gelqere. Kjo do te sherbeje edhe per ngritjen e nderteses s'ambulances ashtu edhe per ate te shkolles fillore. Ne pregatitjen e materjalit per ndertimin e shtepis kooperative asht sjelle ne vendin e punes nji sasi prej 508 metrash kub gure, 290 meter kubik zalle dhe 440 lande te gdhenduna.

Ne te gjitha keto punime, si ne hapjen e themeleve, punimin e tyne dhe te mureve per ndertesen e shtepis kooperative, frontistat e keshillit popullor te Junikut kane dhane 43.648 ore pune vullnetare. Perveç punes vullnetare ata kane dhane per fondin financjar te ndertimit te kooperatives shumen prej 310.000 dinaresh.

Populli i Junikut asht i pari ne rrethin e Gjakoves qe e ka fillue punen nder muret e kesaj ndertese. Deri tash jane gadi 180 meter kubik mure. Si ma i miri keshill vendit per korrjen e rezultateve ma te mira ne ndertimin e shtepis kooperative, ai ka fitue flamurin kalimtar te rrethit te Gjakoves

Nga ekonomija lokale

Punimi i llokumit ne Prizren

Ne vjetin 1946, llokumi prodhohej prej sipermarrjes „NAMA", ku punojshin pak specjalista. Me sypriminin e „Names" veglat e punes dhe puntorija kaluen ne dispozicjon te granapit, i cili deri dikuer prodhon te llokum vetem per nevojet e qytetit te Prizrenit dhe pak per Krahinen. Kur sheqeri filloi te shitet me çmim te lire, tue pa se llokumi konsumohej edhe nder viset tjera te Serbis, granapi e shtoi numrin e puntoris me 70 vete. Ne marrveshtje me sipermarrjet e ndryeshme tregtare shtetnore, granapi eksporton llokum si ne Beograd ashtu edhe nder qytetet tjera te Serbis. Shi ne kohen kur llokumi kerkohej ma shum, fillon te soset niseshtja, elementi i domosdoshem per fabrikimin e llokumit. Sigurisht, po t'ishte parapa me kohe ne plan prej keshillit te qytetit, ashtu siç asht kene propozue prej granapit sigurisht nuk do te ndodhte qe puntorija te mbetet pa niseshte dhe njikohesisht edhe pa pune. Me gjithate me autorizimin e keshillit te qytetit granapi mujti me terhjeke nji sasi niseshteje nga Beogradi, por edhe kjo sasi nuk e garanton punen, por vetem per nji kohe te shkurte. Perveç niseshtes granapi nuk e merr me kohe dispoziten e sheqerit prej Drejtoris se Pergjithshme t'industris ushqimore te Beogradit. Ne mungesen e ketyne dy landeve, do te shkaktohet qe te pezullohet ky sektor i ekonomis lokale te Prizrenit, prandaj asht mire qe te bahen perpjekjet e duhuna me kohe.

Perpjekjet e para per formimin e kooperatives se pare per brisqi ne Krahine

Granapi i qytetit te Prizrenit, tue pa se brisqit konsumohen jo vetem ne Krahinen t'one, por edhe ngjeti, kane ndermarre qe te formoje ne qytet nji kooperative prej zanatlijve te brisqeve. Deri tash nuk ka muejte me mbrrijte qe t'i bindi zanatlijte qe te hyejne ne nji kooperative te ketille, prandaj asht e nevojshme qe t'a ndihmoje edhe Organizata e Frontit Popullor, tue ua skjarue mire zanatlijve dobin e kooperativizmit, sukseset ne pune, sigurimin e tyne etj.

Granapi ka lidhe kontrate me sipermarrjen „Koteks" qe ajo t'ia dorzoje te gjithe brinat qe do t'i mbledhe ne teritorin e Serbis.

Ne rrethin e Drenices jane korre suksese te mira ne kontraktimin e drithnave

Ne rrethin e Drenices asht perpunue mire Dekret-ligji i ri mbi blemjen e detyrueshme dhe kontraktimin e drithnave. Jo vetem qe Fronti popullor e ka perpunue dhe spjegue mire me organizatat e veta si ne qender ashtu edhe nder katunde, por edhe Keshilli popullor i rrethit e ka perpunue mire ate me keshillat e vendeve etj.

Nder katunde jane mbajte konferenca te veçanta, ku kane marre pjese massat katundare dhe perfaqsues nga Fronti popullor i rrethit dhe nga Bashkimi i kooperativave bujqesore te rrethit.

Si rezultat te organizimit dhe punes se mire kallzon vete fakti se katundaret e kane kuptue mire randesin dhe dobin qe u sjelle dekret-ligji i ri, prandaj ata mbrenda tri ditesh kane kontraktue gjithsejte 367,515 kgr: drithna. Vetem ne keshillin e vendit Serbice jane kontraktue mbrenda po kesaj kohe, 41,800 kgr. drithna.

Kontraktimi asht tue vazhdue gjithkuji e me sukses.

Fazli Velia

Lajmrim

Ne numrin e ardhshem do te botohet me hollesi parada dhe manifestimi fiskultural i Krahines s'one - zhvillue ne Prishtine me 13 e 15 te ketij muejit.

Rritja e krymbit te mendafshit ne Gjakove

Mbrenda Planit pesvjeçar, sikurse zhvillimit te çdo kulture tjeter, i asht çele gjithashtu perspektive edhe rritjes se krymbit te mendafshit. Fronti i Grues Antifashiste te Gjakoves ka marre inisjativen me rrite nji sasi krymbash mendafshit, dhe kete ia ka besue shoqes Xhejlan Shahsivarit, e cila çdo dite gjindet ne dhomen ku jane vendose tezgat me buba.

Ajo na tregon se posa krymbat kishin mbushe 7 dite qe kishin çele, ishin rrite bukur mire. Perveç dy sofrave te mdhaja, kishte vue dhe dy tezga njena mbi tjetren te mbushuna me mija e mija krymbash.

"Tash-tha Xhejlani do t'i bajme tufat per me u-ngjite krymbat ne to, si edhe do t'i shperndajme ma gjane nder tezga te vueme ne forme raftesh".

Njikohsisht na tregoi edhe nji katamoje edhe Organizata e Frontit Popullor mendafshit, ne te cilin na spjegoi fazen e tashme te bubave qe ajo po rrite.

—Kur bahen krymbat per me lidhe meshiken shoqe?-e pyes un ate.

—Edhe pese jave, e besoj se do te nxjerrin ma se 100 kgr. mendafsh prej ketyne-pergjigjet ajo.

Tue u-nda nga shoqja Xhejlan, na tha: "sivjet i vuen si perngut, se ne vjetin e ardheshem do te baje gjithshka qe te çele edhe pese-gjashte here ma shum se tash, dhe do te ndihmoje edhe te tjeret qe kane me dashte me u-marre me rritjen e krymbit te mendafshit".

Do t'ishte mire qe kultura e rritjes se krymbit te mendafshit te praktikohej prej te gjithve nder shtepija, mbasi mendafshi asht nji produkt i mire e i vlefshem.

(T.H.)

Bibliografi

Duel ne qarkullim fjalori Serbo-kroatisht-Shqip

Nder keto dite duel ne qarkullim fjalori serbokroatisht-shqip, per punimin e te cilit asht kene angazhue ne Tirane komisjoni redaktues prej profesorve: Voislav S. Dançetoviq, Aleksander Xhuvani, Kostaq Cipo dhe Dr. Ekrem Çabej, tue pase ne ndihme si bashkepuntore profesoret: Pashko Geci, Zagorka Filipoviq, Mark Ndoja, Aleks Buda dhe Ivan Brabec.

Fjalori permban ma se 20.000 fjale. Ky, ka karakter thjeshte praktik. Do t'u sherbeje mjaft nevojeve te zyrave te pushtetit dhe shkollave. Me ane te ketij do t'i bahet nji lehtesi e madhe zhvillimit te leteratyres shqipe, derisa per perkthime, adaptime librash e pjesesh tjera letrare, perkthyesat detyroheshin me çilelu nji seri fjaloresh ne gjuhe te ndryshme, si bj. fj. ate serbisht-frengisht, serbisht-gjermanisht, serbisht-italisht etj. Me ane te ketij fjalori do te kursehet mjaft mundi dhe koha e personave qe merren me ket fushe veprimi.

Ky fjalor ka me sherbye mjaft ne zhvillimin t'one kultural.

M. I. KALINJIN

Miljona vjete te kursyeme

Kane kalue gadi njiqind vjete qysh se duelen maqinat e para bujqesore, toka filloj te punohet ma mire, te plehnohet me plehun artificjal. Por ne Rusin e mbrapambetun cariste katundari as nuk ka mujte te mendoje per maqinat mbjellese, korrse ase fshise. Maqinat punojshin vetem ne pasunit e gjana te çifligarve dhe kulakve. E te vorfenit gjate te tane jetes kane vuejte ne arat e dobeta te veta, ase e kane lerue krejte token dhe kane kerkue fitimin e pasigurte te qyteteve.

Pushteti sovjetik ua ka dhane token bujqve te zellshem, i ka bashkue arat e tyne te ngushta me pasunit e madhaja kolhozjane, ka dergue ne katund me qinda mija traktora, kombajna e maqina tjera.

Perpara, dy njerezve u duhej me i perdore te gjitha fuqit e veta, me ece neper are 10 ore te plota, per te lavrue me permenden e keqe nji hektar toke. Sot, dy njerez-shoferi ne traktor dhe drejtuesi i pllugjeve-e kryejne te njejten pune per 20 minuta!

Maqinat jo vetem e kane lehtesue dhe shpejtesue punen bujqesore,- ato i kane shtue edhe frytet e saje. Pllugu i traktorit lavron ma thelle, maqina mbjellse mbjelle ma barazisht, e te gjitha keto e shtojne prodhimin. Por nuk asht mjaft me fitue frytin e mire,- nevojitet me e mbledhe ket shpejt dhe pa derdhje.

Puna e dores asht e ngadalshme. Prej te zbardhunit te drites deri ne perendim te diellit, shtate veta, mezi arrijshin me e korre drithin e nji hektarit, mandej i bajshin duejt deri ne lame, dhe i fshijshin per nji kohe te gjate me shkopij. Tue korre me drapen ose kose, derdhej dhe humbte sasi e madhe drithi, po ashtu edhe kur fshihej me shkopij e transportohej, derdhej aq shum sa per çdo vjet katundaret bjerrshin me miljona puda drith.

Sot, maqinat korrse, maqinat kositse, maqinat lidhese te duejvet dhe kombajnat i mbledhin shpejt te korrunat, e fshijne shpejt dhe e ruejne kokrren, kursejne fuqin dhe kohen e njeriut. Ma e mira e ketyne maqinave asht kombajni: Kjo bashkon ne vehte edhe korrsen edhe fshisen, e edhe hjedhesen.

Pllugu i traktorit e ka shkurtue punen e 10 oreve ne 20 minuta, kombajni-punen e 70 orve ne 30 minuta. Me fjale tjera, nji minute pune ne pllugun e traktorit zavendeson gjyse ore, e ne kombajne tri ore e gjyse pune te ndheshme dore. Vetem nji minute! Prej ketyne minutave bahen dite e muej, vjete e mija vjete. Per ket te vertete mund te bindemi lehte.

Ne vjetin 1937, ne punet e traktorave kane shpenzue gadi 221 miljon dite pune ne njerez. Sikur keto pune te kryheshin me dore, do te duheshin ma teper se nji miljarde e gjymes dite pune. Pra, vetem per nji vjet traktorat, kombajnat dhe maqinat tjera, e bile jo krejt, kane kursye ne bujqesi punen e miljona njerezve, ase ma pikerisht-1.285.000.000 dite pune. Po u-llogarit se nji vjet ka 280 dite, atehere kjo kapet ne me se 4,5 miljona vjete.

Tre njerez punojne per dite me dore nga 10 ore, e mbledhin dhe e fshijne te korren e nji hektarit per nji jave dite. Ne kombajne po ashtu tre njerez-shoferi, kombajnisti dhe ndihmesi i tij-e kryejne te njejten pune per 30 minuta!

Prej kesaj del se me miljona vjete nuk maten vetem distancat ndermjet hyjve. Sa ma shum maqina te kete vendi, aq ma mire efrytezohet secilanjena prej tyne, aq ma teper kursehet pune dhe kohe, aq ma i pasun asht vendi.

19
Qershuer 1948

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

Vdekje Fashizmit — Liri Popullit!
„Rilindja" Botore e perjavshme. Redaksija: Rruga Emin Duraku Nr. 1 — Prishtine. Pajtimet i pranon Administrata dhe ekspedicioni „Rilindja". Numri i celefonit 38 — 90 60 50.
Takse postale e pagueme

T'a lufltojme çdo pengese ne rrugen e perfshimjes se fuqis puntore rezerve n'ekonomi

Per çdo dite nder minjerat t'ona, nder fabrika, e ndermarrje, nder rruget e objektet e ndryeshme kerkohen puntor te thjeshte dhe te kualifikuem. Me gjithe kete, ne Krahinen t'one ende ka njerez punuesa, qe rrijne pa pune, per shkak se ende nuk kane muejte me u-shkpute nga do mentalitete te vjetra, qe i demtojne si ata dhe familjet e tyne, ashtu edhe komunitetin t'one, gja qe, prap, don te thote me e damtue vetvehten, sepse shteti i jone asht shteti i popullit puntuer.

Se sa dobi te madhe kane puntoret qe punojne nder minjerat e Krahines t'one, ne fabrika etj., e kallzon vet fakti i jetes se tyne nder vendet e punes. T'a marrim puntorin e minjeres. Ai punon 8 ore ne dite jase ma pak sipas llojit te punes, ushqehet mire ne menze po te jete pa familje, fjetjen e ka ne rregull, defrehet, perparon jo vetem ne pune, por edhe ne drejtimin kultural. Sjperblehet mire, i teprojne mjaft pare per familje, e njikohesisht i jepet mundesija te furnizohet mjaft, shpesh dhe lire tekstil e gjana te nevojshme per shtepi.

E pse kitu ne Krahinen t'one disa, e sidoemos shqiptar, rrijne pa pune? Ata, te cilet sot ndonse jo vetem jane njoftue, por edhe thirre shpesh here nga sindikata dhe pushteti qe te dergohen nder vende pune. Nji pjese e tyne i shtrohen zakonit prapanik e te damshem mos me u-largue nga pragu i shpis, e nji pjese tjeter e ka per turp me u-marre me nji pune qe "nuk ia ka pase zakon as baba as babgjyshi". Si njeni mendim, ashtu edhe tjetri jane krejt te gabueshem e i damtojne rande. Disa here ketyne shkaqeve i shtohet edhe tjetri: ke disa njerez te ketille ende bajne efekt fjalet e nji grushti te vogel anmiqesh, qe aty ketu, me politiken e tyne reakcjonare, mundohen t'a ndalojne hovin e massave popullore punuese ne ndertimin e socjalizmit, d.m.th. jetes se tyne ma te mire.

Ne Vendin t'one ka pune per te gjithe njerzit e ndershem. Nuk ka pune per spekuluesa, por ka per te gjithe ata, qe duen me u-kallzue qytetare te denje te Jugosllavis se re.

Perjudha deri ne mbajtjen e Kongresit te V-te te Partis Komuniste te Vendit t'one, nen udheheqjen e se ciles asht fitue dhe po ndertohet Jugosllavija e re, si vend i drejtesis shoqnore, le te jete edhe perjudha e mobilizimit te te gjitha fuqive t'ona puntore rezerve ne punen per ndertimin e atdheut t'one.

I. MUHAXHIRI

Frontistat na shkruejne

Me ka ra rasti personalisht te shtrohem ne spitalin Krahinuer te Prizrenit para pak ditesh. Me nji here, rash ne kontakt dhe ne bisede me te smundet, me motrat e spitalit etj. Te gjithe ankoheshin ne doktor Coiçin. Qe ne mengjes e deri ne mbramje, asht i dejun-natyrisht detyren per te cilen asht ngarkue, nuk mundet me e krye si duhet, vetem shkel e shko.

Nji dite paraqiten ne rengen te spitalit nepunesi i keshillit te rrethit Dervish Gasnin dhe katundari Zeqir Selmani nga Rahoveci. Keta, aty i kishte percjelle mjeku kontrolluer. Qe te dy, ashtu si hine edhe dulen. Dok tori i nxori pa "behune". Te smundet thojshin: "si mundet qe na te jemi te shendoshe, kurse menzi qendrojme ne kambe". Per t'u sigurue ma mire, ata u-drejtuen ne rengenin e Dispanserit dhe dulen qe te dy t'infektuem.

A duhet te lejohet nji qendrim i ketille?

SH. BRAHA

Nga situata nderkombtare

N'Itali, Qeverija e De Gasperit n'asnji menyre nuk po mundet me i shue grevat e bujqeve - puntore

Grevat e puntoreve buiq n'Italin e veriut, te cilat vazhdojne tash nji muej, nuk jane aspak çfaqje e rastit dhe e perkohshme. Kjo asht vazhdimi llogjik i luftes se gjate dhe te ngulte qe e ban per toke proletarjati bujk i Italis. Per me u-spjegue shkaqet e ketyne grevave, mjafton me u-permende se n'asnji vend modern kapitalist nuk shprehen aq fort mbeturinat e rendit feudal sa n'Itali, vendin klasik te te vorfenve katundare, ku armata dermuese prej 7.200.000 proletaresh bujq-pa toke, jetojne nen kushtet e shtypjes ma te zeze feudale. Me ardhjen ne pushtet te partis Demo-Kristiane, te cilen e udheheqin Vatikani e Shtetet e Bashkueme t'Amerikes, kisha dhe pronaret e medhaj e zhvillojne ofansiven kundra turmave katundare. Mbas votimeve te 18 prillit, borgjezija agrare, e inkurajueme nga mashtrimi elektoral i demokristjaneve, e konsideroi se iu dha fund demokracis n'Itali dhe i prishi te gjitha kontratat e punes dhe te drejtat e puntoreve bujq. Me gjith 'ate, ata u-mashtruen keqas.

Nga lajmet prej Italije, shifet se grevat e puntoreve bujq i kane perfshie kryesisht provincat veriore, ku turmat e te pa tokeve kane marre pjese aktivisht ne luften partizane dhe jane koshjente mbi te drejtat e tyne. Ne provincat e Polezines, Rovigos, Bolonjes, Padoves, Ferrares, Venecjes, Mantoves, Furlandis se Poshtme dhe krahinave te tjera gjate tane bregut te lumit Pò, levizja greviste ka perfshi ma se 200.000 te pa toke. Ka randesi fakti se kjo levizje masovike i ka vue vehtes per qellim korrjen jo vetem te kushteve ma te mira jetsore, por edhe respektimin e lirive sindikale e demokratike. Ne disa nga provincat, si ne Mantova, Polezina, e Roviga, te pa-toket mbas 20 dite greve, te pergjithshme e thyen frontin e pronareve te medhaj dhe mberrijten kontrata te reja puneje, shljenin e medijeve dhe shtesa te tjera te jashtzakonshme.

Qysh ne ditet e para te greves, puntoret bujq hasen ne rezistence te madhe te pronareve te medhaj, qeveris e te kishes. Me gjith deklaratat e tij hipokrite mbi perparimin e bujqesis dhe permiresimin e pozites se katundarit, De Gasperi e autorizoi ministrin e policis, pronarin e madh siçiljan Shelben, qe me metodat e tija te njoftuna t'i qeroje hesapet me puntoret bujq. Aradhet sulmuese te policis, qe perbahen prej fashistave e kriminelave, e derdhen gjakun e puntorit ne sulmin e tyne ndeshkues mbi grevistat ne Treçento. Perveç dy puntoreve te vrame, deri tash jane plagose ma se 200 grevista. Per me i mprojte interesat e pronareve te medhaj dhe per me e shtype zgjuemjen e klases se te vorfenve katundare, pushteti mbajtesat, keto greva i kane proklamue si te „jasht ligjeshme" dhe i kane mbushe burgjet me udheheqsa te sindikateve dhe me prijsat e organizatave katundare. Puntoreve bujq, kjo nuk ua humbi gjakftoftesin. Ata i leshuen pronat e zotnive dhe i vuen rojet e veta prane hambareve dhe shtallave te pronarve te medhaj. Shtrajkbreheret, emigrantat fashista nga kampet e personave t'instaluem, te cilet Shelba i çoi neper pronat e mdhaja për me e thye rezistencen e grevistave, u-ndoqen me shelen e lopata nga ana e grave te puntoreve bujq. Dhe kur nga karrot e blindueme amerikane policet e Shelbes i shprazen rafalet ne turmat e puntoreve bujq, puntoret ivdustriale t'Italis se veriut e ngrijten zanin e tyne protestues dhe te solidarsis me proletarjatin bujk. Demostratat e ashpra dhe grevat e pergjithshme te puntoreve ne Bolonja e Kremona e bane qeverin klero-amerikane me e vue gishtin ne kokë e me u-kujtue se kundra vehtes ka miljona puntore e katundare, te cilet nuk do te lejojne kurrsesi qe vendi i tyne te shendrrohet ne latifundin e patronatit agrar te Shelbos dhe ne koloni te Marshallit. Puntoret e fabrikave ne Torriskoza japin ma se 50 per qind te meditjeve te veta per ndihme te grevistave, e neper te gjitha sipermarrjet industriale te provincave veriore shvillohet akcioni per mbledhjen e ndihmave. Ky sulm i bashkuem i puntoreve te fabrikave dhe te proletarjatit katundar tregon se n'Italin e veriut kane falimentue perpjektet e dedektivit amerikan, Sarragatos, qe me demagogjin e rrejshme socialiste t'i shmangi puntoret italjane nga rruga te cilet i ka vue Fronti Demokratik.

Kleri i Vatikanit, aleati besnik i te gjitha regjimeve kundra popullore n'ate vend, u-çue se bashku me qeverin kundra kerkesave te drejta te puntoreve bujq. Me urdhenin e qendres nga Vatikani, pelftrijt u-kercnohen grevistave me xhehnem dhe perjashtimin nga kisha, ne qofte se nuk kthehen neper pronat e zotnive fisnike. Me anen e sindjkatave te veta, kisha predikon dogma se greva asht „nji faj i pa falshem vdeksuer". Vatikani perzihet ne greva, sepse don qe populli te jetoje ne lemoshe e t'a mbaje ate edhe ma tutje n'erresine e mjerim.

Keto greva te puntoreve bujq jane karakteristike per luften ne mes te taborrit demokratik n'Itali dhe te bllokut reaksjonar, i cili ua shet pamvaresin politike e ekonomike zotnive te dollareve. Kjo lufte do t'ashpersohet gjithnji ma teper, sepse standardi i mjerueshem jetsor i shtyn turmat e shfrytzueme n'ofansiven e hapet per buke e toke. Ngrija e perbashket e puntoreve industriale dhe meditsave bujq, asht nji nga vijat ma pozitive te grevave te sotshme n'Itali. Krijimi i ketij bashkimi te turmave puntore jep garancin se reaksjoni i mbrendshem dhe Vatikani, nuk do te mundet me i realizue planet robnuese dhe urdhnat e zotnive te tyne nga Vashingtoni. (Tanjug)

Ne Shtetet e Bashkueme t'Amerikes shtohet vazhdimisht ndjekja e elementave perparimtare

Keshilli tane-keq i dhomes Perfaqsuese per shqyrtimin e veprimtaris antiamerikane dhe byroja Federale per shqyrtimin e loajalitetit te nepunsave shtetnore i kryejne pa u-pengue punet e veta te terrorit dhe frikzimit, perpilojne „lista te zeza" t'organizatave e personaliteteve dhe kerkojne debimin e denimin e secilit qe guxon me e kritikue politiken kundra demokratike te qeveris se Trumanit.

Ne „listen e zeze" te 37 organizatave, te cilat ministri amerikan i drejtsis, Klark, i ka regjistrue si „rrenihese", dhe anetaret e te cilave do te debohen nga sherbimi shtetnor, ndodhet edhe keshilli Amerikan per ndihma Jugosllavis i cili nuk merret me kurfar politike, por ka vetem per qellim qe me anen e kryqit kuq t'i ndihmoje popujte Jugosllavis ne perpjekjet e tyne ne rindertimin e ndertimin e vendit te vet. Ne liste ndodhet edhe komiteti i Unjisuem i amerikaneve me gjini sllavesh te jugut, si dhe kongresi i pergjithshem sllav amerikan.

Ne gjuetin e eger te tyne, reakcjonareve amerikane nuk u-mbrene zemra para askujt e kurrfar mjeti. Nga te gjitha shkollat e universitetet debohen profesoret te cilet e perkrahin kandidatin per President te partis se trete perparimtare, Henri Vallacin. Te tjereve u bahen haptazi kercnime se do te debohen ne qofte se shprehen per Vallacin.

Para pak kohe jane denue me burgim e gjobe ne te holla 10 artista perparimtare filmash sepse kane refuzue me deklarue para keshillit per veprimtarin antiamerikane mbi bindjen e tyne politike. Avokati Leges, i cili po ashtu asht gjykue per arsye se nuk ka deshte me deshmue para Keshillit, tue ia mohue te drejten qe ia jep statuti, gjate shoqnimit te tij deri ne burg u-lidh me zinxhire.

Gjate ketyne muejve te fundit, jane burgose edhe ma se 100 persona te cilet simbas vendimit te ministrit te drejtsis Klavk duhet te ndiqen nga vendi.

Me rastin e ketyne masave te ndjekjeve dhe te frikzimeve mbi popullin amerikan, Komiteti Nacjonal i Partis Komuniste e dha nji deklarate per shtypin ku thuhet: „I ftojme sindikatat, te gjithe qytetaret amerikan e organizatat, qe t'i dyfishojne perpjekjet ne menyre qe t'u jepet fund ketyne masave te turpshme hitlerjane dhe te pengohet gjuetija e ministrit te drejtsis kundra njerzve, per shkak te kuptimit e veprimtaris se tyne politike".

Populli amerikan jep gjithnji ma teper shprehje urrejtjeje kundra nji politike t'atille profashiste, tue u-ngrejte kundra pjelles ma te re te historis antikomuniste te pushtetmbajtesave nga Vashingtoni — kundra projekt ligjit Muntov i cili vetem i plotson masat e ligjet e deritashme kundra demokratike e kundra puntore. Ne te gjitha anet e Shteteve te Bashkueme t'Amerikes mbahen mitingje masovike protestuese, me mija delegata te shoqnive e organizatave te ndryshme shkojne ne Vashington, per me protestue ne Kongres. Personalitetet e dallueme te jetes kulturore e artistike qohen per çdo dite kundra ketij projekt ligji, i cili perfaqson nji hap te ri; ne rrugen e futjes se fashizmit ne Shtetet e Bashkueme t'Amerikes.

(Tanjug)

Presidenti Truman i vueni hekurudhat Amerikane nen pushtetin ushtarak per me shtype greven e puntoreve hekurudhore

Mbrenda dy vjetve te fundit, per heren e dyte ne Shtetet e Bashkueme t'Amerikes, hekurudhat po vehen nen pushtetin ushtarak, ne momentin kur puntoret hekurudhor kerkuen shtimin e rrogave. Prijsat e sindikatit te puntorve hekurudhor t'Amerikes Veriore tash shum kohe zhvillojne bisedime me kompanit hekurudhore mbi shtimin e rrogave. Me qene se pronaret e kompanive dhe perfaqesuesit e pushtetit i refuzuen kerkesat e drejta te puntoreve hekurudhore, dyqind mij puntor hekurudhor t'Amerikes se Veriut vendosen ne mesin e Majit per me i shpalle grevat. N'ate moment dhet ne skene presidenti Truman, i cili nxori nji seri masash, te cilat palen per qellim me i detyrue puntoret hekurudhor, per me koncesjone ne favor te kompanive hekurudhore. Nji nga ato masa asht ndalimi i te drejtes se greves, gjoja per sigurimin e kombit.

Me qene se SH. B. A. ligjirisht ndodhen ende ne gjendje lufte e pergatitje, prandaj njikohsisht presidenti Truman, ne momentin kur puntoret hekurudhor duhet t'a shpallshin greven dha urdhen mbi marrjen e tane rrjetes hekurudhore t'Amerikes se Veriut nga ana e ushtris dhe, me kete gja i shkeli te drejtat demokratike te qytetarve amerikan per me luftue per te drejtat sociale. Ai emnoi shtate kolonela ne çdo drejtori te rrjetes hekurudhore, te cilve u caktoi per detyre qe „me çdo kusht" t'a sigurojne punen e hekurudhave. Njikohsisht asht interesant fakti se keta kolonela jane njikohsisht edhe kryetar te kompanive hekurudhore.

Ky asht vetem nji shembull i vogel, por i fuqishem se si dhe deri ku qytetaret amerikan mund t'i gezojne te drejtat demokratike. Njikohsisht kjo asht edhe deshmi, se ne shtetet kapitaliste fuqija ushtarake sherben per pengimin e shpalljes se vullnetit te popullit dhe t'aspiratave te tij. Dhe ne kete menyre hekurudhat amerikane ne periudhen paqsore te mbas luftes qarkullojne nen kontrollin e ushtris ashtu edhe ne kohen e luftes, gja qe asht ne kundershtim te plote me ato qe perfaqsuesit e SH. B. A. zyrtarisht ose jo-zyrtarisht deklarojne ne vend ose jasht tij.

(Tanjug)

Rinija perparimtare e Polonis jep gjithshka nga vehtja per ndertimin e Vendit te vet populluer-demokratik

Rinija perparimtare e Polonis, neper suksesei e medhaja ne ndertimin e Polonis se re populloro-demokratike, e realizon ne veper bashkimin e organizatave te veta, me anen e te cilave elementat e ndryshem prapanik e te djathte jane perpjeke me e perça rinin, dhe n'ate menyre t'a dobsojshin frontin demokratik te rindertimit e ndertimit.

Ndreimi i pare i 22 brigadave, tashma, punon ne rindertimin e Varashaves, limanit te Shqeqinshut dhe ne ngritjen e objekteve me randesi ne Krahinen Shlon. Perveç kesaj, brigadat punojne ne Varshave, ta filluen punimeve pregaditore ne ngritjen e shtepis se madhe te rinis-qendres se udheheqsis t'organizates se re te rinis dhe simbolit te bashkimit te levizjes se rinis. Ne ket vere, tri ndrrime te brigadave punojse me afer 75 mije te rij, do te japin ne mbare vendin ma se pakti 11 milion ore pune ne rindertimin e ndertimin. Nen udheheqjen „Sherbimi Polonis" me qinda mije te rij e te reja do te punojne nga tri dite ne muej ne rindertimin e ndertimin e shkollave, shtepive popullore, n'elektrifikimin e radjofonizimin e vendit dhe ne punime te tjera me karakter lokal. (Tanjug)

Botim i Keshillit Krahinuer te Frontit populluer—Shtypshkroja Krahinore e Frontit Populluer Pajtimet ne fletore i pranon: Administrata dhe ekspedicioni.